



**GJEOGRAFIA
E SIGURIMEVE**

**POZICIONI NË TREG I GRUPIT
EUROSIG-INSIG**

2021

HYRJE

Gjeografia e Sigurimeve 2021 – Pozicioni i Grupit Eurosig-Insig Në Treg, është një raport i cili hartohet mbi bazë të nevojave të analizës së ecurisë së aktivitetit të Grupit Eurosig – Insig. Raporti synon evidentimin e pozicionit të grupit në rang prefekturë duke e krahasuar me tregun dhe shoqëritë e tjera konkurente. Indikatorët kryesorë të analizës janë primet e shkruara bruto dhe dëmet e paguara për vitin 2021, si edhe raportet përkatëse që rrjedhin nga këto tregues. Burimi kryesor në të cilin mbështetet raportin është “Gjeografia e Sigurimeve 2021” publikuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Përveç analizës së Gjeografisë së Sigurimeve 2021 në Republikën e Shqipërisë, raporti analizon edhe tregun e sigurimeve të Shqipërisë krahasuar me vendet e rajonit, bazuar në raportin e publikuar nga XPrimm “Insurance Report” për shtetet e Europës Qendrore e Lindore dhe Europës Jugperëndimore.


Grupi Eurosig-Insig shtrin aktivitetin e tij në 12 prefekturat e vendit me 47 degë dhe agjenci, nëpërmjet këtij raporti evidentohet pozicioni në treg dhe performanca e njësive të grupit në prefekturat përkatëse.

Tabela e Përmbajtjes

H Y R J E	2
1. Tregu i Sigurimeve gjatë vitit 2021 në Republikën e Shqipërisë dhe Europë	4
2. Të dhëna të përgjithshme për tregun e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë	6
3. Pozicioni i Grupit Eurosig-Insig në prefekturat e Republikës së Shqipërisë	8
3.1 Prefektura e Beratit.....	10
3.2 Prefektura Dibër.....	11
3.3 Prefektura Durrës.....	12
3.4 Prefektura Elbasan	13
3.5 Prefektura Fier	14
3.6 Prefektura Gjirokastrë.....	15
3.7 Prefektura Korçë	16
3.8 Prefektura Kukës.....	17
3.9 Prefektura Lezhë	18
3.10 Prefektura Shkodër	19
3.11 Prefektura Tiranë	20
3.12 Prefektura Vlorë.....	21


1. Tregu i Sigurimeve gjatë vitit 2021 në Republikën e Shqipërisë dhe Europë

Tregu i sigurimeve të Jetës dhe Jo Jetës gjatë vitit 2021 në Republikën e Shqipërisë ka realizuar 19,267.8 milion lekë prime të shkruara bruto dhe ka paguar 6,665.58 milion lekë dëme. Bazuar në të dhënat e Raportit Vjetor 2021 XPRIMM, indikatorët kryesor ekonomik të Shqipërisë paraqiten si më poshtë;




Gjatë vitit 2021, Shqipëria me një rritje të përgjithshme ekonomike 8.54%, normë papunësie 10.60% (në rënie me 1.08% krahasuar me vitin 2020), paraqet një treg sigurimesh me një normë penetrimi në treg afro 1.02% e Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP-së), në rritje me 0.01% nga viti 2020. Karahasuar me vendet e tjera të Europës Qendrore dhe Juglindore, Shqipëria mban nivelin më të ulët të raportit të primeve të sigurimeve ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto. Edhe Kosova mban nivelin më të lartë më afro 1.56% të GDP-së. Një tjetër matës i aktivitetit të tregut të sigurimeve paraqitet jo eficient për vendin krahasuar me rajonin. Densiteti i sigurimeve, i matur si raport i volumit të primeve ndaj popullsisë për Republikën e Shqipërisë rezulton 56 euro për frymë, raporti më i ulët në rajon, ndërkohë për Kosovën ky raport rezulton 66 euro/frymë.

Grafiku 1: Penetrimi i tregut të sigurimeve (%)



Burimi: XPrimm, përpunoi autori

Grafiku 2: Densiteti i tregut të sigurimeve (euro/frymë)



Burimi: XPrimm, përpunoi autori


Në një analizë edhe të ecurisë së treguesve gjatë pesë vjeçarit 2017 – 2021, Shqipëria ka përmirësim të treguesve të penetrimit dhe densitetit krahasuar me vitin paraardhës, mirëpo gjatë gjithë periudhës paraqet ndër raportet më të ulëta të rajonit, duke evidentuar nivelin e ulët të zhvillimit të tregut të sigurimeve. Sipas grafikut 1, tregu i sigurimeve në Turqi paraqet raportin më të madh të volumit të primit me totalin e Prodhimit të Brendshëm Bruto, duke bërë që penetrimi i tregut të sigurimeve të jetë afro 4.12%, ndjekur nga Kroacia me 2.72%. Ndërkohë, raport nën 2% paraqesin Serbia (1.92%), Kosova (1.56%) dhe e fundit Shqipëria me 1.02%. Primi për frymë i gjeneruar nga tregu i sigurimeve, përkufizuar si densiteti i sigurimeve ka shënuar rritje me 9 euro/frymë më shumë se viti 2020 (47 euro/frymë në vitin 2020), por pavarësisht rritjes paraqitet si vlera më e ulët në rajon. Referuar grafikut 2, Greqia mban vlerën më të lartë të primeve për frymë afro 399 euro/frymë, ndjekur nga Kroacia dhe Mali i Zi. Sipas përshkrimit të raportit XPrimm mbi perspektivat e tregut të sigurimeve në Europën Qendrore dhe Juglindore për vitin 2022, konstatojnë se pas një vitit rikuperues si 2021, fillimi i vitit 2022 u duk premtues. Megjithatë, si pasojë e luftës Rusi – Ukrainë edhe pse nuk prek vendet në mënyrë direkte në luftë, indirekt shfaq pasoja të rënda. Vendet janë shumë të ndjeshme ndaj importit të gazit të Rusisë, kanë lidhje të ngushta me tregjet në Ukrainë, normat e larta të inflacionit do ndikojnë në cmimet e konsumit dhe investimet. Duke dalë në përfundimin që viti 2022, nuk do jetë një vit i lehtë, por tregjet e sigurimeve të vendeve në studim kanë dëshmuar

që janë mjaftueshëm elastik për t'u përballur me një tjetër krizë ekonomike. (XPrimm, Insurance Report Full Year 2021)

2. Të dhëna të përgjithshme për tregun e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë

Struktura e tregut të sigurimeve vijon të mbizotërohet nga aktiviteti i Jo Jetës, ku gjatë vitit 2021, 92.57% e primeve të shkruara bruto realizohen nga aktiviteti i Jo Jetës dhe 91.00% e kontratave të nënshkuara nënshkruhen nga aktiviteti i Jo Jetës.


Grafiku 3: Struktura e tregut të sigurimeve



Burimi: AMF, përpunoi autori


Edhe në dëmet e paguara të tregut, pjesën më të madhe e zë aktiviteti i Jo Jetës me 94.71%, ndërsa aktiviteti i Jetës me 5.29%. Po ashtu, në numrin e dëmeve të paguara pjesa më e madhe vjen nga aktiviteti i Jo Jetës, të ilustrara në grafikun 4.

Grafiku 4: Përpjesa e dëmeve të paguara



Burimi: AMF, përpunoi autori

Grafiku 5: Përpjesa e primeve të prefekturave në tregun e sigurimeve




Pjesa më e madhe e primeve të tregut realizohet nga prefektura e Tiranës, e cila zotëron më shumë se gjysmën e tregut me 57.80% të tregut, e ndjekur më pas nga Durrësi me 7.91% dhe Fieri me 5.34%. Ndërkohë të fundit renditen Kukësi (1.19%), Dibra (1.77%) dhe Gjirokastra (1.91%).

Burimi: AMF, përpunoi autori

Lidhur me llojet e sigurimeve, prefektura e Tiranë në të gjitha klasat e sigurimeve vullnetare zë më shumë se 80% të primeve, duke evidentuar shkallën e ulët të sigurimeve vullnetare në prefekturat e rretheve.


Grafiku 6: Primet sipas llojeve të sigurimit në prefektura



Burimi: AMF, përpunoi autori

3. Pozicioni i Grupit Eurosig-Insig në prefekturat e Republikës së Shqipërisë

Figura 1: Përpjesa e Grupit Eurosig-Insig në treg




Në vitin 2021 Grupi Eurosig & Insig u rendit në vendin e dytë në tregun e sigurimeve të Jo Jetës, duke grumbulluar 3,549,899,272 lekë prime të shkuara bruto. Krahasuar me vitin 2019, shënohet rritje me 14.49%. Pjesa ndaj totalit të tregut që Grupi Eurosig dhe Insig zotëron në këtë periudhë është 19.93%. Sipas prefekturave në Republikën e Shqipërisë, grupi pozicionohet si më poshtë:

1. Berat – Vendi 2
2. Dibër – Vendi 3
3. Durrës – Vendi 3
4. Elbasan – Vendi 1
5. Fier – Vendi 2
6. Gjirokastrë – Vendi 1
7. Korçë – Vendi 1
8. Kukës – Vendi 2
9. Lezhë – Vendi 2
10. Shkodër – Vendi 2
11. Tiranë – Vendi 3
12. Vlorë – Vendi 2

Burimi: AMF, përpunoi autori

Figura 2: Pozicioni i Grupit Eurosig-Insig në treg sipas prefekturave



Burimi: AMF, përpunoi autori


3.1 Prefektura e Beratit

Prefektura e Beratit zotëron 2.36% të tregut të sigurimeve të Jo Jetës për vitin 2021, ose 419,725,000 lekë. Raporti i sigurimeve të detyrueshme me vullnetare është 96.65% me 3.35%, krahasuar me vitin 2020 tregu ka shënuar rritje me 11.91%. Ndërkohë treguesit kryesor demografik dhe të tregut të sigurimeve paraqiten si më poshtë.


- Popullsia: 115,050
- Sipërfaqja e Prefekturës (km²): 1,798
- Primi i Shkruar Bruto (000 lekë/ALL): 420,517
- Dëme të paguara (000 lekë/ALL): 84,378
- Primi për frymë (lekë/frymë): 3,655.08

Grupi Eurosig-Insig në tregun e prefekturës së Berati zotëron 20.71% të tregut duke e renditur në vendin e dytë, me 86,939,000 lekë prime të shkruara bruto. Krahasuar me një vit më parë, grupi ruan të njëjtin pozicion në klasifikim. Pjesa më e madhe e primeve të grumbulluara të grupit, vijnë nga sigurimet e detyrueshme motorike duke bërë që raporti i sigurimeve të detyrueshme me ato vullnetare të jetë 98.97% me 1.03%. Dëmet e paguara nga Eurosig-Insig në prefekturën e Beratit janë 20,793,000 lekë të cilat përbëjnë 24.94% të totalit të tregut, duke sjell një raport dëme/prime 23.92%. Të gjitha dëmet e paguara vijnë nga mbulimet që ofrojnë sigurimet motorike të detyrueshme.

Grafiku 7: Ndarja e tregut 2021 – Berat¹



Grafiku 8: Dëme të paguara 2021 – Berat



¹ Për të gjitha grafikët në vijim (Grafiku 7-30) burimi i informacionit është “Gjeografia e Sigurimeve 2021” nga AMF dhe të përpunuara nga autori.


3.2 Prefektura Dibër

Gjatë vitit 2021 prefektura e Dibrës ka realizuar 1.77% të primeve të shkruara bruto të tregut të sigurimeve të Jo Jetës, në vlerë 314,420,000 lekë, ndër prefekturat me përqindjen më të ulët në treg. Tregu dominohet nga sigurimet e detyrueshme motorike me një raport 95.14% me 4.86% vullnetare. Krahasuar me primet e realizuara në vitin 2020, tregu shënon 23.93% rritje e cila vjen nga klasa e sigurimeve motorike.


- Popullsia: 109,585
- Sipërfaqja e Prefekturës (km²): 2,586
- Primi i Shkruar Bruto (000 lekë/ALL): 314,775
- Dëme të paguara (000 lekë/ALL) : 66,516
- Primi për frymë (lekë/frymë): 2,872.43

Grupi Eurosиг-Insig ka grumbulluar 62,043,000 lekë në prefekturën e Dibrës, të cilat përbëjnë 19.73% të tregut. Bazuar në këto të dhëna grupi renditet në vend të tretë. 99.47% janë sigurimet e detyrueshme motorike, ndërkohë pjesa tjetër vjen nga sigurimet e aksidenteve dhe në përqindje të pakonsiderueshme klasat e tjera. Vlera e dëmeve të paguara të Eurosиг-Insig në qarkun e Dibrës është 10,353,000 lekë, duke paguar 15.56% të totalit në këtë treg. Raporti dëme/prime rezulton 16.69%.

Grafiku 9: Ndarja e tregut – Dibër



Grafiku 10: Dëme të paguara - Dibër




3.3 Prefektura Durrës

Prefektura e Durrësit është një nga prefekturat më përqëndrimin më të madh të popullsisë në Republikën e Shqipërisë, e cila rrjedhimisht sjell një nga tregjet me përpjesën më të lartë të tregut të sigurimeve, duke zotëruar 7.91% të tregut të Republikës së Shqipërisë ose 1,409,426,000 lekë, e dyta pas Tiranës. Krahasuar me vitin 2020 primet janë në rritje me 16.99%. Raporti i sigurimeve të detyrueshme me ato vullnetare është 84.68% me 15.32%.


- Popullsia: 291,325
- Sipërfaqja e Prefekturës (km²): 766
- Primi i Shkruar Bruto(000 lekë/ALL): 1,421,409
- Dëme të paguara (000 lekë/ALL): 575,336
- Primi për frymë (lekë/frymë): 4,879.12

Grupi Eurosig-Insig në prefekturën e Durrësit realizon 236,779,000 lekë ose 16.80% të tregut. Grupi renditet në vend 3 duke ruajtur të njëjtin vend në klasifikim si në vitin 2020. Raporti i sigurimeve të detyrueshme motorike me vullnetare është 94.55% me 5.45%. Vlera e dëmeve të paguara nga Eurosig-Insig është 70,023,000 lekë ose 12.29% të tregut, e cila sjell raport dëme/prime 29.57%. Prefektura Durrës është prefektura me raportin më të lartë dëme/prime ku për gjithë tregun është 40.42%. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara nga Eurosig-Insig janë për sigurimet e detyrueshme motorike.

Grafiku 11: Ndarja e tregut 2021 – Durrës



Grafiku 12: Dëme të paguara 2021 – Durrës




3.4 Prefektura Elbasan

Prefektura e Elbasanit grumbullon 4.76% të totalit të primeve të tregut të Jo Jetës ose 848,332,000 lekë prime të shkruar bruto në vlerë, në rritje me 11.17% krahasuar me vitin 2020. Rritje e cila vjen kryesisht nga sigurimet e detyrueshme motorike dhe sigurimet e përgjegjësiive civile. Tregu ka një raport të sigurimeve motorike me vullnetare 90.79% me 9.21%.


- Popullsia: 259,112
- Sipërfaqja e Prefekturës (km²): 3,199
- Primi i Shkruar Bruto (000 lekë/ALL): 858,012
- Dëme të paguara (000 lekë/ALL): 222,782
- Primi për frymë (lekë/frymë): 3,311.36

Grupi Eurosig-Insig në tregun e sigurimeve të Jo Jetës në prefekturën e Elbasanit realizon 265,967,000 lekë prime të shkruara bruto, të cilat përbëjnë 31.35% të totalit. **Këto të dhëna pozicionojnë Grupin Eurosig-Insig në vend të parë në treg**, njëjtë si pozicioni i vitit 2020, duke ruajtur pozitën e liderit të tregut për këtë prefekturë. Raporti i sigurimeve të detyrueshme me ato vullnetare është 94.44% me 5.54%. Dëmet e paguara të Eurosig-Insig janë 60,735,000 lekë, duke paguar 27.65% të dëmeve të tregut. Raporti dëme/prime është 22.84%.

Grafiku 13: Ndarja e tregut 2021 - Elbasan



Grafiku 14: Dëme të paguara 2021 – Elbasan




3.5 Prefektura Fier

5.34% e primeve të realizuara nga tregu i sigurimeve të Jo Jetës grumbullohen në prefekturën e Fierit. Totali i primeve të shkruara bruto është 951,889,000 lekë, në rritje me rreth 5.47% krahasuar me vitin 2020. Raporti i sigurimeve të detyrueshme me ato vullnetare është 92.27% me 7.72%.


- Popullsia: 278,413
- Sipërfaqja e Prefekturës (km²): 1,890
- Primi i Shkruar Bruto (000 lekë/ALL): 958,717
- Dëme të paguara (000 lekë/ALL): 207,811
- Primi për frymë (lekë/frymë): 3,443.51

Grupi Eurosиг-Insig në tregun e sigurimeve të Jo Jetës në qarkun e Fierit realizon 200,982,000 lekë prime të shkruara bruto, 21.11% të totalit. Grupi renditet në vend të dytë, i njëjti pozicion me renditjen e vitit 2020. Raporti i sigurime të detyrueshme me ato vullnetare është 95.61% me 4.39%, ku grupi ushtron aktivitetin e tij pothuajse me të gjitha llojet e sigurimeve të tregut. Vlera e dëmeve të paguara nga Eurosиг-Insig në prefekturën e Fierit është 37,017,000 lekë, të cilat përbëjnë 17.96% të dëmeve të paguara të tregut. Raporti dëme/prime është 18.42%.

Grafiku 15: Ndarja e tregut 2021 - Fier



Grafiku 16: Dëme të paguara 2021 – Fier




3.6 Prefektura Gjirokastrë

Prefektura e Gjirokastrës realizon 340,937,000 lekë prime të shkruara bruto, ose 1.91% të primeve të shkruara bruto të tregut të sigurimeve të Jo Jetës për vitin 2021. Totali i primeve është në rritje me rreth 8.79% krahasuar me vitin 2020. Rritje e ardhur kryesisht nga sigurimet e detyrueshme motorike dhe klasa e aksidenteve e sëmundjeve. Raporti i sigurimeve të detyrueshme motorike me ato vullnetare është 93.01% me 6.99%.


- Popullsia: 55,278
- Sipërfaqja e Prefekturës (km²): 2,884
- Primi i Shkruar Bruto (000 lekë/ALL): 344,213
- Dëme të paguara (000 lekë/ALL): 60,704
- Primi për frymë (lekë/frymë): 6,226.94

Në prefekturën e Gjirokastrës grupi Eurosig-Insig realizon 139,450,000 lekë prime, të cilat përbëjnë 40.90% të primeve të tregut. **Eurosig-Insig renditet në vend të parë**, duke ruajtur të njëjtin pozicion në klasifikim me një vit më parë. Pjesa më e madhe e primeve të realizuara vjen nga sigurimet e detyrueshme motorike 97.47% e tyre ndërsa 2.54% nga sigurimet vullnetare. Vlera e dëmeve të paguara të Eurosig-Insig në Gjirokastrë është 19,582,000 lekë, të cilat përbëjnë 32.43% të dëmeve të paguara të tregut. Raporti dëme/prime është 14.04%. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara vijnë po ashtu nga sigurimet e detyrueshme motorike, për Eurosig-Insig po ashtu paralelisht edhe për tregun.

Grafiku 17: Ndarja e tregut 2021 - Gjirokastrë



Grafiku 18: Dëme të paguara 2021 – Gjirokastrë




3.7 Prefektura Korçë

Në prefekturën e Korçës grumbullohen 851,755,000 lekë prime të shkruara bruto nga tregu i sigurimeve të Jo-Jetës, të cilët përbëjnë 4.78% të totalit të tregut në Republikën e Shqipërisë. Raporti i sigurimeve të detyrueshme me ato vullnetare është 92.99% me 7.01%. Krahasuar me primet e realizuara në vitin 2020, tregu është në rritje me 15.11%, e shkaktuar kryesisht nga rritje e sigurimeve të detyrueshme dhe aksidenteve.


- Popullsia: 197,303
- Sipërfaqja e Prefekturës (km²): 3,711
- Primi i Shkruar Bruto (000 lekë/ALL): 859,960
- Dëme të paguara (000 lekë/ALL): 160,958
- Primi për frymë (lekë/frymë): 4,358.58

Grupi Eurosig-Insig në prefekturën e Korçës renditet në vendin e parë në treg me një diferencë të thellë me vendin e dytë të tregut, duke realizuar pothuajse dyfishin. Totali i primeve të grumbulluara është 344,224,000 lekë, ose 40.41% të tregut të prefekturës. **Krahasuar me vitin 2020, Eurosig-Insig ruan pozicionin udhëheqës të tregut.** Raporti i sigurimeve të detyrueshme me ato vullnetare është 98.10% me 1.90%, ku nga sigurimet vullnetare klasa e aksidenteve ka përpjesën më të madhe. Vlera e dëmeve të paguara të Eurosig-Insig është 39,695,000 lekë, të cilat përbëjnë 25.00% të dëmeve të paguara në këtë treg. Këto tregues sjellin raport dëme/prime 11.53%.

Grafiku 19: Ndarja e tregut 2021 - Korçë



Grafiku 20: Dëme të paguara 2021 – Korçë




3.8 Prefektura Kukës

Prefektura e Kukësit është prefektura e cila zotëron pjesën më të vogël të tregut të sigurimeve në Republikën e Shqipërisë, duke zotëruar vetëm 1.11% të tij. Nga tregu i Jo Jetës realizohen 212,725,000 lekë, të cilat përbëjnë 1.19% të tregut. Raporti i sigurimeve të detyrueshme me ato vullnetare është 97.14% me 2.86%. Krahësuar me vitin 2020 tregu i Jo Jetës është në rritje me 13.90%, ardhur kryesisht nga rritja e sigurimeve të detyrueshme motorike.


- Popullsia: 72,768
- Sipërfaqja e Prefekturës (km²): 2,374
- Primi i Shkruar Bruto (000 lekë/ALL): 213,990
- Dëme të paguara (000 lekë/ALL): 52,810
- Primi për frymë (lekë/frymë): 2,940.71

Grupi Eurosig-Insig në prefekturën e Kukësit realizon 66,713,000 lekë prime të shkruara bruto, ose 31.36% të tregut. Në këtë prefekturë Eurosig-Insig renditet në vendin e dytë, e njëjta pozitë me vitin e kaluar. Pjesa më e madhe e primeve realizohet nga sigurimet e detyrueshme motorike, në një raport 98.57% me 1.43% me ato vullnetare. Vlera e dëmeve të paguar nga Eurosig-Insig është 24,843,000 lekë ose 48.01% të dëmeve të paguara të tregut, **duke paguar pjesën më të madhe të dëmeve të tregut. Raporti dëme/prime është 37.24%, po ashtu raporti më i lartë i tregut.**

Grafiku 21: Ndarja e tregut 2021 - Kukës



Grafiku 22: Dëme të paguara 2021 – Kukës




3.9 Prefektura Lezhë

Nga tregu i sigurimeve të Jo Jetës në prefekturën e Lezhës realizohen 456,222,000 lekë prime të shkruara bruto, duke zotëruar 2.56% të tregut në vend. Krahasuar me vitin 2020, ky treg shënon rritje me 8.14%, ku përveç klasës së sigurimeve të marinës dhe kreditit, klasat e tjera janë me rritje. Raporti i sigurimeve motorike me vullnetare është 91.18% me 8.82%.


- Popullsia: 117,283
- Sipërfaqja e Prefekturës (km²): 1,620
- Primi i Shkruar Bruto (000 lekë/ALL): 462,415
- Dëme të paguara (000 lekë/ALL): 181,955
- Primi për frymë (lekë/frymë): 3,942.73

Në prefekturën e Lezhës totali i primeve të realizuara nga grupi Eurosиг-Insig është 110,412,000 lekë, renditur në vend të dytë me 24.20% të tregut, duke qëndruar në të njëjtat pozita si në vitin 2020. Paralelisht me tregun, edhe Eurosиг-Insig ka një treg të dominuar nga sigurimet motorike 95.09% me 4.91% vullnetare. Vlera e dëmeve të paguara nga Eurosиг-Insig është 29,079,000 lekë ose 16.05% të dëmeve të paguara të tregut, të ardhura të gjitha nga mbulimet e sigurimeve motorike. Raporti dëme/prime rezulton 26.34%, ndërsa raporti i tregut është 39.70%.

Grafiku 23: Ndarja e tregut 2021 – Lezhë



Grafiku 24: Dëme të paguara 2021 – Lezhë




3.10 Prefektura Shkodër

Prefektura e Shkodrës realizon 4.89% të primeve të shkuara bruto të sigurimeve të Jo Jetës në Republikën e Shqipërisë, ose 871,627,000 lekë. Tregu është në rritje me rreth 17.29% nga viti 2020, ardhur kryesisht nga rritja e ndjeshme e sigurimeve të detyrueshme motorike. Raporti i sigurimeve motorike me vullnetare është 91.69% me 8.31%.


- Popullsia: 193,009
- Sipërfaqja e Prefekturës (km²): 3,562
- Primi i Shkruar Bruto (000 lekë/ALL): 890,639
- Dëme të paguara (000 lekë/ALL): 166,399
- Primi për frymë (lekë/frymë): 4,614.49

Grupi Eurosig-Insig në prefekturën e Shkodrës renditet në pozicionin e dytë, duke rënë me një pozicion nga viti i kaluar. Vlera e primeve të shkruara bruto është 202,275,000 lekë ose 23.21% të tregut, ardhur kryesisht nga sigurimet e detyrueshme me 98.32% të totalit. Nga totali i sigurimeve vullnetare të cilat janë 1.68% e totalit, klasa e sigurimit të pronës zë pjesën më të madhe. Dëmet e paguara nga Eurosig-Insig janë 24,043,000 lekë ose 14.53% të dëmeve të paguara të tregut. Në raport me primet e shkruara bruto dëmet janë 11.89%. E gjithë vlera e dëmeve të paguara vjen nga mbulimet e sigurimeve motorike, kryesisht motorikeve të detyrueshme.

Grafiku 25: Ndarja e tregut 2021 – Shkodër



Grafiku 26: Dëme të paguara 2021 – Shkodër




3.11 Prefektura Tiranë

Tirana ka përqëndrimin më të lartë të popullsisë në vend dhe pjesa më e madhe e primeve të sigurimit realizohet në këtë prefekturë. 10,293,631,000 lekë janë primet e realizuara nga tregu i Jo Jetës, ose 57.80% e tregut në vend. Raporti i sigurimeve të detyrueshme me vullnetare është 49.07% me 50.93%, raporti më i favorshëm i prefekturave. Krahasuar me vitin 2020 primet kanë rritje me 17.24%, ardhur kryesisht nga rritja e sigurimeve të pronës.


- Popullsia: 919,511
- Sipërfaqja e Prefekturës (km²): 1,652
- Primi i Shkruar Bruto (000 lekë/ALL): 11,640,642
- Dëme të paguara (000 lekë/ALL): 4,478,685
- Primi për frymë (lekë/frymë): 12,659.60

Grupi Eurosig-Insig në prefekturën e Tiranës realizon 1,691,953,000 lekë të cilat përbëjnë 16.44% të tregut të Jo Jetës. Grupi renditet në vendin e tretë, i njëjti pozicion si në vitin e kaluar. **Ndërkohë, në klasën e sigurimeve motorike të detyrueshme grupi renditet në vend të parë me 20.73% të tregut.** Raporti i sigurimeve të detyrueshme motorike me ato vullnetare është 61.90% me 38.10%. Vlera e dëmeve të paguara nga Eurosig-Insig është 547,591,000 lekë, duke paguar kështu 13.17% të dëmeve të tregut në këtë prefekturë. Raporti dëme/prime rezulton 32.36%, ndërsa për tregun ky raport është 40.40%.

Grafiku 27: Ndarja e tregut 2021 - Tiranë



Grafiku 28: Dëme të paguara 2021 – Tiranë




3.12 Prefektura Vlorë

Në prefekturën e Vlorës realizohen 4.71% e primeve të shkruara bruto të sigurimeve të Jo Jetës, ose 839,579,000 lekë në vlerë. Ky treg krahasuar me vitin 2020 është në rritje me 12.09%, ardhur kryesisht nga sigurimet e detyrueshme motorike dhe sigurimet e pronës. Raporti i sigurimeve të detyrueshme motorike me ato vullnetare është 89.19% me 10.81%, ku sigurimet vullnetare janë në rënie krahasuar me vitin 2020.

- Popullsia: 184,955
- Sipërfaqja e Prefekturës (km²): 2,706
- Primi i Shkruar Bruto (000 lekë/ALL): 855,243
- Dëme të paguara (000 lekë/ALL): 138,014
- Primi për frymë (lekë/frymë): 4,624.06

Grupi Eurosig-Insig në prefekturën e Vlorës realizon 142,162,000 lekë prime të shkruara bruto, të cilat e rendisin në vendin e dytë me 16.93% të tregut. Renditja në klasifikim është në rënie me një pozitë nga viti i shkruar, ku grupi renditej në vend të parë. Raporti i sigurimeve motorike me vullnetare është 94.84% me 5.16%. Vlera e dëmeve të paguara nga Eurosig-Insig është 22,135,000 lekë ose 16.21% të dëmeve të tregut. Në raport me primet dëmet e paguara janë 15.57%, pothuajse njëjtë me raportin dëme/prime të tregut i cili është 16.26%.

Grafiku 29: Ndarja e tregut 2021 - Vlorë



Grafiku 30: Dëme të paguara 2021 – Vlorë

